

SHËRBIMET E UJËSJELLËS  
DHE KANALIZIMEVE  
NË RAJONIN E DANUBIT

# SITUATA E SEKTORIT 2018 PERDITËSIM

Përmbledhje ekzekutive dhe përshkrim i shteteve | Qershor 2019

# Përmbajtje

<b>PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME</b>	<b>1</b>	<b>SHTOJCA A: PASQYRAT E VENDEVE</b>	<b>9</b>
Resurset ujore dhe ndryshimet klimatike . . . . .	1	Shqipëria . . . . .	10
Konteksti dhe organizimi i shërbimeve . . . . .	2	Austria . . . . .	13
Qasja në shërbime . . . . .	4	Bosnja dhe Hercegovina . . . . .	16
Performanca e shërbimeve . . . . .	5	Bullgaria . . . . .	19
Financimi i shërbimeve . . . . .	6	Kroacia . . . . .	22
Përfundimet . . . . .	6	Republika Çeke . . . . .	25
		Hungaria . . . . .	28
		Kosova . . . . .	31
		Moldavia . . . . .	34
		Mali i Zi . . . . .	37
		Maqedonia e Veriut . . . . .	40
		Rumania . . . . .	43
		Serbia . . . . .	46
		Slllovakia . . . . .	49
		Slllovenia . . . . .	52
		Ukraina . . . . .	55

**Falënderime.** Ky material është produkt i stafit të Bankës Botërore me kontribute të jashtme. Konstatimet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë material nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Botës Botërore, Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë të saj apo të qeverive që përfaqësojnë. Banka Botërore nuk garanton saktësinë e të dhënave të përfshira në këtë material. Kufijtë, ngjyrat, emërtimet dhe informacionet e tjera që jepen në harta në këtë material nuk përfaqësojnë asnjë gjykim nga ana e Bankës Botërore sa i takon statusit juridik të ndonjë territori apo pranim apo miratim të këtyre kufijve.

**Të drejta dhe leje.** Materiali i këtij botimi është objekt i të drejtës së autorit. Ngaqë Banka Botërore e nxit përhapjen e njohurive të saj, ky botim mund të riprodhohet, i plotë ose pjesërisht, për qëllime jotregtare, me kusht që të citohet titulli i tij. Pyetjet për të drejtat dhe lejet mund t'i drejtoni tek: Office of the Publisher, The World Bank, 1818 H Street NW, Washington, DC 20433, USA; fax: 202-522-2422; e-mail: [pubrights@worldbank.org](mailto:pubrights@worldbank.org)

# PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Ky raport analizon progresin dhe sfidat e 16 vendeve në vijën ujëndarëse të Danubit<sup>1</sup> lidhur me ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme të ujit dhe ujërave të zeza për të gjithë, duke përfshirë përmbushjen e *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian (BE) për fushën e mjedisit, që nga botimi i edicionit të parë të raportit me titull Situata e Sektorit, (në gjuhën angleze State of the Sector), shkurt (SoS), në vitin 2015. Raporti Situata e Sektorit 2015 (SoS 2015) përshkruan në detaje kontekstin historik dhe politik dhe organizimin e shërbimeve në rajonin e Danubit, si dhe sfondin specifik në secilin vend në shënimet e veçanta sipas vendit, ndërsa ky edicion i përditësuar për vitin 2018 i raportit Situata e Sektorit (SoS 2018), përqendrohet në prezantimin e progresit të shënuar në vendet e ndryshme dhe në nivelin rajonal, dhe në kuptimin e tendencave që po shfaqen në katër dimensionet që përbëjnë Vlerësimin e Qëndrueshmërisë së Sektorit (WASCO)<sup>2</sup>. Këto katër dimensione janë: niveli i qasjes në ujësjellës dhe shërbime sanitare, cilësia e shërbimeve të ofruara (dhe kënaqshmëria e konsumatorëve me to), performanca dhe efikasiteti i ofruesve të shërbimeve dhe financimi i shërbimeve. Raporti shqyrton më për së afërmi disa nga dimensionet WASCO për të identifikuar agjendat kryesore të përbashkëta për të ardhmen e sektorit në rajonin e zhvillimit; “ofrimi në destinacion” për furnizimin me ujë; agjenda e menaxhimit të shërbimeve sanitare dhe të ujërave të zeza, duke pasur si sfond aspektet e përfshirjes sociale dhe pajtueshmërinë me standardet e BE-së, dhe potenciali për më shumë përfitime me përdorimin sipas nocionit “nga mbeturina në resurs” dhe “qasjet e vijës ujëndarëse”; dhe agjenda e përmirësimeve operative dhe e efikasitetit të shërbimeve komunale të ujit. Raporti përfshin një kapitull të veçantë për menaxhimin e resurseve ujore dhe ndryshimet klimatike, duke marrë parasysh rëndësinë në rritje të temës për vendet në rajon dhe në nivelin global, me ndryshimet klimatike që manifestohen në planet kryesisht përmes efekteve të tyre në ciklet e ujit. Në këtë sferë kritike, raporti përqendrohet në identifikimin e fushave për vëmendje, si dhe boshllëqet e njohurive, ku nevojiten më shumë informacione për vendet që të menaxhojnë siç duhet resurset ujore dhe rreziqet që lidhen me ujin në këtë kontekst në ndryshim e sipër. Raporti përfundon duke i bërë vendeve thirrje për veprim që të investojnë më tej në zhvillimin e politikave, faktorit njeri dhe partneriteteve, duke qenë të ndihmuar nga teknologjia që është në zhvillim më të shpejtë se kurrë, për t’i lëvizur këto agjenda përpara për një rajon të Danubit me siguri më të madhe të ujit dhe me shërbime më gjithëpërfshirëse, më të besueshme dhe më të rimëkëmbëshme të ujit, të shërbimeve sanitare dhe menaxhimit të ujërave të zeza.

## Resurset ujore dhe ndryshimet klimatike

**Lumi Danub ka basenin e dytë më i madh lumor në Evropë dhe është një nga lumenjtë më ndërkombëtarë të botës, që mbulon më shumë se 800,000 kilometra katrorë (km<sup>2</sup>), me një popullsi totale prej më shumë se 133 milionë banorë në 19 vende,** me peizazh të larmishëm dhe dallime të konsiderueshme në cilësinë dhe sasinë e resurseve ujore, si dhe në klimën në të gjithë basenin. Danubi lidhet me 27 degë të mëdha dhe më shumë se 300 degë të vogla të rrjedhave ujore, nga burimi i tij në Pyllin e Zi në Gjermani deri në Detin e Zi në Rumani dhe, si i tillë, është baseni më i madh ujqor në BE.

**Disponueshmëria e resurseve të ripërtëritshme të ujit brenda basenit të Danubit ka mbetur stabile në përgjithësi gjatë viteve të fundit, me asnjë vend që konsiderohet të ketë mungesë të ujit përveç Republikës Çeke dhe disa vendeve (Ukrainë, Moldavi) që po i afrohen gjendjes së mangësisë fizike të ujit<sup>3</sup>. Sa i përket cilësisë, që nga viti 2009, trupat e ujërave sipërfaqësore në rajonin e Danubit që arrijnë gjendje të mirë ose potencialisht të mirë ekologjike dhe gjendje të mirë kimike<sup>4</sup> kanë vazhduar të përmirësohen,** falë instrumenteve si Direktiva Kuadër e Ujërave, Plani i Menaxhimit të Basenit të Lumit Danub dhe përmirësimit të të dhënave dhe të cilësisë dhe disponueshmërisë së informacionit (përmirësuar ndjeshëm edhe nga data e raportit të parë SoS 2015). Sidoqoftë, trupat ujorë në basenin e lumit Danub vazhdojnë të përfshijnë tepriçë të lëndës organike dhe nivele të ndjeshme të

1 Këto janë Austria, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Kosova, Hungaria, Mali i Zi, Moldavia, Maqedonia e Veriut, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Serbia dhe Ukraina të cilave në këtë raport i referohemi si “rajoni”.

2 Ky indeks i propozuar nga Autorët në raportin e parë SoS 2015 bazohet në gjithsej dymbëdhjetë ndryshore (tri ndryshore nën secilin nga katër dimensionet). Shih shënimet metodologjike për detaje të mëtejshme mbi llogaritjen e WASCO.

3 Republika Çeke, me disponueshmëri totale të resurseve të ripërtëritshme të ujit prej përafërsisht 1240 m<sup>3</sup>/cap/vit, gjithashtu raporton thatësi në 5 vitet e fundit

4 Siç përkufizohet në legjisllacionin e BE-së për ujërat

lëndëve ushqyese, duke prekur veçanërisht trupat e ujërave nëntokësore me rëndësi të gjerë në nivel të basenit. Për shumicën e vendeve të rajonit, ujërat nëntokësore mbeten burimi kryesor për prodhimin e ujit të pijshëm.

**Nga këndvështrimi i menaxhimit të resurseve ujore, legjislacioni i BE-së për ujërat është shtytës i fuqishëm për vendet candidate dhe candidate potenciale për të harmonizuar politikat e tyre të ujërave.** Menaxhimi i ujërave në basen drejtohet nga parimet e Direktivës Kuadër të Ujërave (WFD) e BE-së e koordinuar ndërkombëtarisht nëpërmjet Komisionit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Lumit Danub (ICPDR). Në ditët e sotme, 15 nga 16 vendet e rajonit po ndjekin parimet e WFD, kanë krijuar autoritete për menaxhimin e baseneve dhe po përgatisin Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore (RBMP), krahasuar me 11 vende në 2015. Pothuajse në të gjitha vendet e rajonit, të drejtat për nxjerrjen e ujit dhe lejet për shkarkimin e ujërave të zeza përdoren për grumbullimin e resurseve dhe ngarkohen dhe paguhen sistematikisht (krahasuar me tre vjet më parë).

**Nga 2021 deri në 2050, parashikohet një rritje e temperaturës mesatare vjetore midis 1.3°C në pjesët e sipërme dhe të mesme të basenit të lumit Danub dhe deri në 1.7°C në pjesët e poshtme, dhe rritje të mëtejshme midis 4°C dhe 5°C janë parashikuar për 2071 deri 2100,** bazuar në të dhënat e mbledhura nga ICPDR. Për të mos përmendur transformimin të cilit do të duhet t'i nënshtrohen pothuajse të gjithë sektorët nëse rajoni dëshiron të qëndrojë vetëm 1.3°C më i ngrohtë, sa i përket ujërave, temperatura e rritur do të nënkuptojë ndryshime të përgjithshme të reshjeve me pasoja të pabarabarta (dhe deri në njëfarë shkalle, të pasigurta) në vendet e ndryshme. Edhe nëse reshjet mesatare vjetore pritet të mbeten në përgjithësi pothuajse konstante, ndryshimet në temperaturë dhe reshje mund të shkaktojnë ulje të disponueshmërisë së ujit me ndryshime në modelet sezonale të rrjedhjes të shkaktuara kryesisht nga depozitimim i reduktuar i dëborës dhe sezonaliteti i shprehur i reshjeve. Përveç masave të ndryshimeve klimatike të përfshira në RBMP, shumica e vendeve në rajon kanë adoptuar strategji kombëtare për ndryshimet klimatike; megjithatë, ndikimi specifik i këtyre strategjive në sektorin e ujërave dhe ujërave të zeza ende nuk është përkufizuar dhe implementuar. Shumica e ndërmarreve komunale për ujësjellës dhe shërbime sanitare ende duhet të integrojnë konsideratat e klimës në planifikimin e tyre të rregullt.

**Për të menaxhuar më mirë resurset ujore dhe për t'u përshtatur dhe për të zbutur ndikimin e ndryshimeve klimatike, vendet në basenin e Danubit duhet të fillojnë të krijojnë ekuilibra të saktë të ujërave në shkallët e përshtatshme hapësinore dhe kohore, duke marrë parasysh kërkesat aktuale dhe të ardhshme nga përdoruesit dhe sektorët e ndryshëm të ekonomisë, trajektoret e zhvillimit, nevojat ekologjike dhe parashikimet klimatike, ndër të tjera, për të udhëhequr politikat e ujërave dhe për të shërbyer rezultatet më të mira për shoqërinë, mjedisin, etj. dhe për ekonominë në mbarë territorin e rajonit.**

## Konteksti dhe organizimi i shërbimeve

**Shumë prej vendeve në pellgun ujëmbledhës të lumit Danub kanë trajektore të përbashkët historike** të shënuar nga tranzicioni politik dhe ekonomik nga një qeveri e centralizuar dhe ekonomia socialiste në një model të liberalizmit social që mbështet ekonominë e rregulluar të tregut të lirë dhe zgjerimin e të drejtave civile dhe politike. Agjenda e integritimit në BE është procesi tjetër i përbashkët historik dhe politik i kohëve të fundit i pranishëm pothuajse në të gjitha vendet e rajonit. Ka dallime të mëdha politike dhe kulturore ndërmjet vendeve, por në përgjithësi, ekzistojnë zhvillime në drejtim të konvergencës ndaj standardeve evropiane. Sidoqoftë, ndryshimet në prodhimin e brendshëm bruto (PBB) për frymë janë ende të ndjeshme në të gjitha vendet përgjatë vijës ujëndarëse të Danubit, dhe rreth 2.5 milionë njerëz brenda rajonit të Danubit jetojnë me më pak se \$2.50 dollarë në ditë (pariteti i fuqisë blerëse [PPP]), që paraqet rritje të vogël të varfërisë së matur që nga SoS 2015.

**Ekziston një trend i vazhdueshëm në rënie i madhësisë së popullsisë (nga 135.2 milionë në 2015 në 133.7 milionë në 2018) brenda rajonit të Danubit, për shkak të kombinimit të rritjes së ulët natyrore të popullsisë dhe migrimit të jashtëm** në disa vende, veçanërisht nga vendet e sapo anëtarësuar ose vendet candidate për BE, ku talenti i ri i ka sytë nga BE-ja dhe më gjerë në kërkim të perspektivave më të mira ekonomike. Kjo vazhdon të jetë shqetësuese për shumë vende të rajonit të cilat po përpiqen të ecin përpara në agjendën e vendeve të punës dhe rritjes ekonomike. Në të njëjtën kohë, rajoni po përjeton migracionin ardhës të qytetarëve që po ikin nga konflikti në vendet e tyre. Vëllimi i lartë i flukseve të migracionit të brendshëm (dhe të jashtëm) dhe sezonaliteti i migracionit do të ndikojë gjithashtu në planifikimin e infrastrukturës. Kudo në rajon ka margaritarë të mirëfilltë të natyrës dhe kulturës me potencial të madh

për turizëm eko-miqësor dhe të qëndrueshëm, si dhe qendra turistike të sapo krijuara dhe të konsoliduara, ku popullsia shumëfishohet madje edhe 10-fish në periudha specifike të vitit, gjë që paraqet sfidë për projektimin e sistemeve dhe infrastrukturës për furnizimin me ujë dhe menaxhimin e ujërave të zeza.

**Aderimi në BE i shtatë vendeve të rajonit të Danubit në dekadën e parë të shekullit të 21 të ka nxitur pjesën më të madhe të zhvillimit të jashtëzakonshëm në sektorin e ujërave në vendet e ndryshme.** Shtytësit kryesorë ishin financimi (me fonde të konsiderueshme në formë të granteve nga fondet e kohezionit strukturor të BE-së që kanë për cak arritjen e pajtueshmërisë me direktivat e BE-së lidhur me ujërat) dhe përafrimi i legjislacionit kombëtar me direktivat e BE-së (përmes futjes së parimeve kryesore të politikave, siç është rikuperimi i kostos, ndotësi paguan, efikasiteti i përdorimit, dhe cilësia dhe qëndrueshmëria mjedisore e ujërave dhe trupave ujqorë). Sidoqoftë, shumë vende anëtare të BE-së po kanë vështirësi që të arrijnë pajtueshmërinë brenda periudhave për harmonizim të rëna dakord gjatë negociatave të kapitullit 27 mbi mjedisin (përfshirë ujërat) gjatë procesit të aderimit në BE, gjë që pasqyron se këto mund të kenë qenë tejet ambicioze ose mund të mos kenë konsideruar sa duhet sfidat e shumta që paraqiten nga kapacitetet institucionale dhe teknike të pazhvilluara, modelet e qeverisjes dhe infrastruktura e pamjaftueshme dhe me mirëmbajtje të dobët.

**Në gjashtë vendet kandidate ose kandidate potenciale për BE nga rajoni, procesi i para-aderimit në BE gjithashtu ka nxitur ndjeshëm zhvillimin dhe financimin e sektorit të ujërave,** ngaqë vendet kanë pasur qasje në grantet nga fondet e para-aderimit (Instrumenti i Para-Aderimit (IPA)) dhe i kanë alokuar këto për financimin e investimeve në infrastrukturë në sektorin e ujërave dhe shërbimeve sanitare. Perspektiva e anëtarësimit në BE po ndikon gjithashtu në planifikimin e sektorit dhe zhvillimin e ardhshëm të sistemeve të ujësjellësit dhe shërbimeve sanitare. Për dy vendet në Evropën Lindore që janë brenda pellgut ujëmbledhës (Moldavia dhe Ukraina), Direktiva Kuadër e Ujërave e BE-së është gjithashtu referencë; mirëpo, ndikimi i procesit të ardhshëm të aderimit, si në aspektin e financimit aktual ashtu edhe për nga depërtimi i parimeve të politikave, është më pak i rëndësishëm. Sektori i ujërave në përgjithësi në vendet e rajonit është prekur gjithashtu nga proceset e reformës territoriale dhe administrative, riorganizimet institucionale, krijimi i politikave dhe enteve të reja rregullatore të sektorit, si dhe kornizat e qeverisjes në nivel kombëtar/ nën-kombëtar të nxitura nga realitetet politike dhe shoqërore individuale të këtyre vendeve, si dhe nga marrëdhëniet e tjera bilaterale dhe ndërkombëtare që bashkëjetojnë me perspektivën e aderimit në BE.

**Përpjesa e popullsisë që furnizohet me ujë nga ndërmarrjet publike (d.m.th. nga një ofrues formal i shërbimeve të ujit) është rritur në 82 për qind - rritje prej 8 për qind krahasuar me situatën tre vjet më parë - që pasqyron trendin rajonal drejt zgjerimit të shërbimeve formale dhe rajonalizimit.** Si rezultat, më pak banorë janë duke u mbështetur në vetë-furnizim ose në ofruesit informalë. Përpjesa e banorëve të shërbyer nga ofruesit privatë të shërbimeve është rritur gjithashtu, me nënshkrimin e kontratave të partneritetit publik-privat (PPP) të cilat janë në fuqi për ofrimin e shërbimeve të ujit dhe shërbimeve sanitare në shtatë vende të rajonit. Në zonat rurale, shërbimet e ujit zakonisht organizohen nëpërmjet ndërmarrjeve të shërbimeve komunale të ujit që janë në afërsi, organizatave me bazë komunitare ose me vetë-furnizim. Tash e tutje, do të jetë e rëndësishme për vendet që të hartojnë politika të cilat marrin parasysh një meny të opsioneve për modelet e ofrimit të shërbimeve të cilat mund të sigurojnë ofrimin e sigurt dhe adekuat të shërbimeve për të ecur përpara në agjendën e qasjes.

**Disa vende të rajonit e kanë konsideruar grumbullimin për të përmirësuar efikasitetin dhe performancën dhe për të shtrirë mbulimin në zonat rurale, me nivele të ndryshme suksesi dhe rezultate mikse.** Proceset e suksesshme të rajonalizimit për të integruar zonat rurale u karakterizuan nga një objektiv i qëllimshëm i barazisë dhe me një mandat të qartë, masa të dedikuara për të mbështetur integrimin e sistemeve rurale, si dhe investime me shënjestrim dhe ndihmë teknike për qeveritë lokale dhe ofruesit e shërbimeve për të trajtuar kompleksitetin e çështjes. **Për të arritur me sukses deri te zonat rurale, modele të shumta të menaxhimit mund të kenë nevojë për mbështetje, përfshirë modelin rajonal të shërbimeve komunale, por gjithashtu mbështetje për formalizimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve komunale të shkallës së vogël ose modeleve të organizuara në nivel të komunitetit, si dhe masa mbështetëse për të përmirësuar cilësinë e vetë-furnizimit.**

**Modele të ndryshme të rregullimit ekonomik vazhdojnë të bashkëjetojnë për shërbimet e ujit dhe shërbimet sanitare në rajonin e Danubit, por ekziston një trend drejt rritjes së rregullimit të nivelit qendror,** si në Maqedoni dhe Mali të Zi ku kompetencat e sektorit të ujërave iu shtuan agjencive të tyre kombëtare rregullatore të energjisë në 2016. Numri i rregullatorëve të veçantë për sektorin e ujërave gjithashtu është rritur nga tre në gjashtë ndërmjet 2015 dhe 2018, por këta ndryshojnë shumë për nga efektiviteti dhe pavarësia e tyre.

**Përpjekjet për të evidentuar në vijimësi performancën e shërbimeve komunale dhe për ta krahasuar atë kundrejt homologëve dhe praktikave të mira ndërkombëtare janë në rritje**, me disa agjenci rregullatore dhe shoqata të shërbimeve komunale që përdorin sisteme të ndryshme të menaxhimit të mbledhjes së të dhënave (përfshirë platformën me tre nivele të bazuar në shërbimet komunale DANUBIS DCM të zhvilluar nga DWP), me më shumë se 50 shërbime komunale që marrin pjesë në Programin e Matjes Krahasuese të Shërbimeve Komunale të Partneritetit Mësimor të Danubit, dhe me mjete të tjera të shumta për monitorimin dhe përmirësimin e performancës, dhe me shumë nga këto palë të interesuara (si dhe shërbimeve komunale individuale në të gjithë rajonin EAQ) që ndajnë të dhëna me Ib-net të Bankës Botërore dhe uebsajtin DANUBIS.org që janë në dispozicion të publikut, gjë që tregon qasje të transparencës së rritur.

## Qasja në shërbime

**Në vitin 2015, në nivelin global u miratua Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm**, e cila përcakton përkufizime dhe caqe të reja për arritjen e shërbimeve më të mira (domethënë universale, të barabarta, të sigurta dhe të përbalueshme) dhe më të qëndrueshme të ujit dhe të shërbimeve sanitare. Sipas këtyre treguesve të rinj, **gjysma e vendeve të rajonit ofrojnë shërbime të ujit të pijshëm të menaxhuara në mënyrë të sigurt për së paku 90 për qind të banorëve të tyre<sup>5</sup>, ndërsa vetëm pesë vende të rajonit raportohet që ofrojnë shërbime sanitare të menaxhuara në mënyrë të sigurt për më shumë se 75 për qind të popullsisë së tyre** (tre vende ofrojnë shërbime sanitare të menaxhuara në mënyrë të sigurt për më pak se 25 për qind të popullsisë së tyre).

**Qasja në rrjetin e ujësjellësit dhe shërbime të kanalizimeve është rritur përgjithësisht gjatë periudhës së raportit; rreth 17 për qind e popullsisë në rajon (më shumë se 22 milionë banorë) ende nuk ka qasje në furnizim nga rrjeti i ujësjellësit që nga rishikimi i fundit i SoS.** Në përgjithësi, mungesa e qasjes së rregullt është e përhapur në vendbanimet rurale ose me popullsi më pak të dendur, të cilat shpesh nuk përcaktohen me prioritet në agjendat politike dhe zakonisht nuk përmbushin kushtet e ekonomisë së shkallës për të ofruar shërbime të rrjetit nëpërmjet infrastrukturës së rrjetit të ujësjellësit me kosto efektive. Edhe më shumë sesa furnizimi me ujë nga rrjeti i ujësjellësit, **ka mbetur prapa qasja në shërbime sanitare të menaxhuara në mënyrë të sigurt.** Mungesa e shërbimeve adekuate sanitare është gjithashtu më e përhapura në zonat rurale ose zonat me densitet të ulët të popullsisë, **dhe rreth 5.5 milionë banorë, ose 4 për qind e popullsisë së rajonit, kanë qasje vetëm në shërbime sanitare të papërmirësuara<sup>6</sup>.** Shumica e popullsisë me shërbime sanitare të papërmirësuara është në zonat rurale, dhe dy të tretat janë në Rumani.

**Pjesa e popullsisë e lidhur me sistemet për trajtimin e ujërave të zeza ka evoluuar ndryshe nga vendi në vend në rajonin e Danubit, dhe mbetet agjendë me pak investime në vendet kandidatë dhe jo-anëtarë të BE-së.** Disa shtete anëtare të BE-së (Republika Çeke, Hungaria dhe Bullgaria) kanë arritur të rrisin shkallën e lidhjeve në më shumë se 70 për qind, ku dy të tretat e popullsisë së lidhur marrin shërbime të trajtimit terciar. Vendet e tjera anëtare të BE-së kanë mbetur prapa (p.sh. Rumania), ose shkalla e lidhjes së tyre për trajtimin e ujërave të zeza ka ngecur gjatë pesë viteve të fundit (p.sh. Sllovenia dhe Kroacia). Në vendet kandidatë, është bërë pak përparim meqë ujërat e zeza mbledhen kryesisht pa u trajtuar, përveç në Shqipëri, dhe disa zhvillimeve në BeH. Sfidat kryesore përfshijnë kufizimet e financimit dhe kapacitetet e dobëta, gjë që rezulton në nevojë për investime në kapacitete që tejkalojnë fondet e disponueshme, vështirësi në mirëmbajtjen dhe operimin e sistemeve ekzistuese të ujërave të zeza, kostot e larta financiare që potencialisht janë përtej kostove të përbalueshme, dhe (mos) disponueshmëria e fondeve për rinovimin e infrastrukturës.

**Rritja e qasjes në të tre shërbimet (uji, shërbimet sanitare dhe menaxhimi/grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të zeza) mbetet sfidë për të gjitha vendet e rajonit, veçanërisht në zonat më pak të dendura për nga popullsia. Mbushja e boshllëkut ndërmjet shërbimeve rurale-urbane është ende sfidë e rëndësishme që do t'i kërkojë vendeve të hartojnë strategji specifike për të zgjeruar shërbimet në zonat rurale dhe të punojnë për të krijuar mjedis të favorshëm për të njohur dhe mbështetur modelet e ndryshme të ofrimit të shërbimeve që janë në dispozicion**

<sup>5</sup> Këta numra përfshijnë gjithashtu shërbimet e vetë-furnizimit kur qytetarët marrin ujin nga tubacionet në oborrin ose banesën e tyre (me supozimin se bëhet fjalë për ujë që nuk është i kontaminuar). Prandaj, menaxhimi i sigurt nuk nënkupton medoemos që është "i rregulluar" dhe që ofrohet nga një ofrues i shërbimeve.

<sup>6</sup> Një njësi e papërmirësuar është ajo që nuk i veçon në mënyrë efektive mbeturinat nga kontakti njerëzor. Përkufizimi i OZHQ-ve për aspektet higjienike të shërbimeve sanitare gjithashtu përfshin që në afërsi të ekzistojnë njësi për pastrimin e duarve

**për të adresuar nevojat specifike të zonave rurale (përfshirë mekanizmat e vetë-furnizimit), ndërkohë që do të shqyrtojnë mundësitë e ofruara nga lulëzimi i teknologjisë (veçanërisht në shërbimet sanitare lidhur me sistemet e decentralizuara dhe në lokacion) dhe risitë në mekanizmat e financimit (përfshirë sektorin privat).** Megjithëse shërbimet komunale në nivel rajonal dhe urban mund të jenë në gjendje të arrijnë deri te një pjesë e konsiderueshme e popullsisë rurale, në disa vende, modelet paralele të operatorëve lokalë mund të vazhdojnë të sjellin shërbime për fshatarët. Përveç kësaj, për popullsitë e shpërndara dhe të largëta, megjithëse duke u kurrur për nga madhësia, një sistem i rrjetit publik të ujësjellësit mund të mos jetë i realizueshëm dhe vetë-furnizimi është alternativa e vetme e zbatueshme, ndërsa sistemet e decentralizuara jashtë rrjetit (ose zgjidhjet në lokacion me zbrazje të rregulluar) mund të jenë modeli më i përshtatshëm për ujërat e zeza, veçanërisht kur kërkohen zgjidhje të bazuara në natyrë që mund të gjenerojnë përfitime plotësuese që kontribuojnë në modelin e ekonomisë qarkore.

## Performanca e shërbimeve

**Në përgjithësi, cilësia e shërbimeve, sa i përket vazhdimësisë dhe pajtueshmërisë me standardet e cilësisë së ujit (në ato raste kur monitorohet cilësia e ujit) dhe standardet e shkarkimit të ujërave të zeza në rajon është përmirësuar që nga shqyrtimi i vitit 2015.** Në përgjithësi, një pjesë e madhe e popullsisë në rajon tani merr shërbime të vazhdueshme 24/7 në krahasim me tre vjet më parë, megjithëse në nivelin individual, vazhdimësia është përkeqësuar ose ka ngecur në disa vende. Matja e konsumit është rritur gjithashtu në nivelin rajonal, gjë që me sa duket po rezulton të ketë sukses si mjet i menaxhimit të kërkesës, me rënie të ndjeshme të konsumit në shtatë vendet që iu nënshtruan studimit, megjithëse tarifat më të larta në këto vende mund të kenë luajtur gjithashtu rol në rënie e konsumit mesatar. **Kënaqshmëria e konsumatorëve përgjithësisht ka mbetur stabile ose është përmirësuar** dhe, ndesh me intuitën, me sa duket është më e lartë në zonat rurale edhe pse nivelet e shërbimeve nuk janë medoemos më të mira në këto zona, gjë që tregon se mbështetja e modelit të vetë-furnizimit mund të jetë me përfitim në disa raste me mbikëqyrje të përshtatshme. Megjithatë, ka pasur pak përparim në përmirësimin e mekanizmave të mbrojtjes së konsumatorëve.

**Sa i përket efikasitetit të ofruesve të shërbimeve, ekzistojnë edhe tendenca pozitive.** Gjatë viteve të kaluara, uji i pafaturuar (NRW) ka ndjekur evolucion mjaft të larmishëm në mbarë rajonin, ku gjysma e vendeve të Danubit kanë shënuar përmirësime në shifrat e raportuara të NRW ose e kanë mbajtur atë në shkallë stabile dhe gjysma tjetër kanë raportuar rritje të NRW. Për të nxjerrë përfundime mbi punën e ofruesve të shërbimeve/performancën e vendeve në lidhje me eficiencën e energjisë janë të nevojshme më shumë të dhëna; megjithatë, analiza tregon rënie të kostove të energjisë për metër kub (m<sup>3</sup>) të ujit të prodhuar, gjë që mund të jetë tregues i përdorimit më eficient të energjisë edhe pse ka të ngjarë që uljet e kostove janë nxitur nga ulja e kostove të energjisë. Efikasiteti i personelit është ruajtur ose përmirësuar, me pesë vende që kanë përmirësuar produktivitetin e personelit të tyre që nga raporti i parë SoS 2015. Efikasiteti tregtar i shërbimeve komunale në rajon në përgjithësi është i qëndrueshëm dhe po përmirësohet, me katër vende të reja që kanë arritur të përmirësojnë raportet e grumbullimit mbi 90 për qind që nga SoS 2015.

**Performanca e shërbimeve komunale në rajonin e Danubit është rritur që nga viti 2013, e matur me Indeksin e Performancës së Shërbimeve Komunale të Ujit (WUPI)<sup>7</sup>.** Në përgjithësi, rritja për të gjitha shërbimet komunale që iu nënshtruan studimit ishte 4.2 pikë, duke llogaritur faktin se mostra themelore e shërbimeve komunale ka ndryshuar me kalimin e viteve. Ndonëse ka disa tendenca divergjente brenda vendeve, rezultatet e WUPI në nivelin e vendit janë përmirësuar të gjitha ose kanë mbetur stabile në pothuajse të gjitha vendet që nga raporti i parë SoS në 2015.

**Ndërsa janë identifikuar tendenca pozitive në lidhje me cilësinë dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve, gjithashtu mbetet shumë hapësirë për të vazhduar me përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për të gjithë popullsinë e basenit të Danubit dhe përmirësimin e performancës operative dhe financiare të ofruesve të shërbimeve,** dhe ka kursime të ndjeshme monetare që mund të gjenerohen duke vazhduar përqendrimin në veprimet e politikave për përmirësimin e performancës dhe mbështetjen e përmirësimit të efikasitetit të kostos nga ofruesit e shërbimeve.

7 Indeksi i Performancës së Shërbimeve Komunale të Ujit (WUPI) është indeks specifik i performancës i llogaritur nga ekipi i autorëve (shih Kutia 8) për të matur performancën e përgjithshme të shërbimeve komunale (sa i përket mbulimit me shërbime, cilësisë së shërbimeve dhe menaxhimit) kundrejt parametrave të ndryshëm.

## Financimi i shërbimeve

**Financimi i sektorit do të duhet të rritet në mënyrë dramatike në vendet jo-anëtare të BE-së në mënyrë që vendet e rajonit të arrijnë konvergjencë me nivele të ngjashme të shpenzimeve në sektor (që nga ana tjetër ka korrelacion të fortë me vlerësimin e qëndrueshmërisë së sektorit).** Niveli i financimit të sektorit ndryshon shumë dhe ka ndjekur tendenca të ndryshme në secilin nga vendet e rajonit në tre vitet e fundit. Megjithëse financimi mesatar për frymë është rritur përgjithësisht me 20 për qind që nga raporti i parë SoS, kjo rritje e përgjithshme maskon një diferencë të madhe në fondet në dispozicion për sektorin ndërmjet vendeve të BE-së, vendeve kandidatë dhe vendeve jo-anëtare të BE-së (tetë herë më pak se shtetet anëtare të BE-së). Shumë prej vendeve me të ardhura të ulëta dhe të mesme të rajonit (kryesisht vendet kandidatë dhe ato jo-anëtare të BE-së) janë gjithashtu në kufirin e ulët të vlerës së pranuar përgjithësisht për financimin e përgjithshëm të sektorit, si pjesë e PBB-së.

**Megjithëse parimi i rikuperimit të kostos gradualisht po përparon në shumicën e vendeve, fondet e BE-së (grantet) ende paraqesin burim të madh të financimit në rajon, veçanërisht për investimet e lidhura me implementimin e Direktivës së Trajtimit të Ujërave të Zeza Urbane (UWWTD).** Një pjesë e rëndësishme e kostove të investimeve të lidhura me UWWTD deri më tani janë mbuluar nga transferimet nga fondet e kohezionit të BE-së për shtetet e reja anëtare të BE-së (të cilat përbëjnë më shumë se 40 për qind të fondeve të investimeve sektoriale në disa vende).

**Në rreth dy të tretat e vendeve, kostot e drejtpërdrejta të operimit për ujësjellës dhe shërbime sanitare mbulohe nga të ardhurat nga tarifat.** Tre vjet më parë, vetëm gjysma e vendeve mund të arrinin mbulim të kostos operative mbi një. Për të ruajtur cilësinë e shërbimit në planin afatgjatë, shërbimet komunale do të duhet të jenë në gjendje të rikuperojnë kostot e tyre të O&M, si dhe ato të nevojshme për menaxhimin e pasurive, si dhe rinovimin e infrastrukturës. Kjo do të duhet të financohet nga të hyrat e tyre vetanake (duke përdorur skemat e përshtatshme të financimit), ose të mbështetet nga alokimet adekuate tatimore nga buxhetet publike.

**Megjithëse tarifat janë rritur gjatë dekadës së kaluar, nivelet aktuale janë ende të përballueshme për konsumatorin mesatar.** Tarifat reale janë rritur me 5 deri në 10 për qind në vit, mesatarisht, gjatë dekadës së kaluar, por po kështu janë rritur edhe të ardhurat e disponueshme të banorëve. Llogaritja e shpenzimeve të raportuara për ujë dhe ujëra të zeza si pjesë e të ardhurave për grupe të ndryshme të ardhurash zbulon se shpenzimi mesatar është mjaft më poshtë pragut prej 5 për qind, ku raportet më të larta janë vërejtur në Ukrainë dhe Rumani (4.4 dhe 4.2 për qind përkatësisht). Vlerësimet e pjesës së shpenzimeve për 40 përqindëshin e poshtëm tregojnë një rritje të vogël, por kufizimet e përballueshmërisë janë të përhapura vetëm në Ukrainë. Sidoqoftë, përfshirja e tarifave të rikuperimit të plotë të kostos (për të reflektuar koston e rinovimit të infrastrukturës në të ardhmen për të ruajtur standardet e tanishme të shërbimit) mund të paraqesë sfida të përballueshmërisë për disa nga vendet e rajonit në të ardhmen e afërt, varësisht nga grupet socio-ekonomike.

Vetëm Kroacia, Hungaria, Maqedonia e Veriut, Sllovenia dhe Ukraina raportojnë se kanë skema formale të subvencionimit për të siguruar përballueshmërinë për përfituesit me të ardhura të ulëta.

## Përfundimet

**Në përgjithësi, ka disa arsye për optimizëm në lidhje me zhvillimin e sektorit në rajon që nga rishikimi i fundit i SOS.** Përpjesa e popullsisë që furnizohet me ujë nga një ofrues formal i shërbimeve komunale (në krahasim me kooperativat informale, të menaxhuara në nivel lokal ose me vetë-furnizimin) është rritur ndjeshëm; cilësia e shërbimeve dhe e performancës së shërbimeve komunale po tregon tendenca pozitive në shumicën e vendeve; financimi i përgjithshëm i sektorit është rritur dhe po rrjedh drejt sektorit, megjithëse jo në shumat e kërkuara; dhe nivelet e rikuperimit të kostos në përgjithësi janë në rritje. Faktorët prapa këtyre zhvillimeve që japin shpresë mund t'i atribuohen shumë elementeve nxitëse. Elementi nxitës kryesor është rritja e shfrytëzimit të më shumë politikave dhe programeve qeveritare të bazuara në evidenca që përfitojnë nga udhëheqja e fortë, investimet e konsiderueshme në kapacitete të përmirësuara në nivele komunale dhe institucionale, sistemet e përmirësuara të njohurive dhe informacionit dhe mbështetja teknike dhe financiare nga BE-ja dhe partnerët tjerë të zhvillimit.

**Përkundër këtij lajmi të mirë, dy agjenda sfiduese - dhe të rëndësishme - janë theksuar në këtë raport.**



- ▶ **Së pari, qasja në agjendën e shërbimeve dhe sigurimi i “ofrimit në destinacion” për të arritur qasjen universale në të tre shërbimet (ujë, shërbimet sanitare dhe menaxhimi/grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të zeza), veçanërisht në zonat rurale.** Agjenda “mos e lër askënd prapa” do të përfshijë adresimin e sfidave të mbetura në kontekstin e rritjes së standardeve të përcaktuara nga OZHQ-të për ujë, shërbime sanitare dhe higjienë (WASH). Qasja e popullsisë në furnizimin nga rrjeti i ujësjellësit po përparon me një shkallë shumë të ulët. Tepër shumë banorë në zonat rurale të rajonit ende nuk kanë qasje të sigurt në furnizimin nga rrjeti i ujësjellësit. Kjo paraqet çështje të barazisë dhe rreziqe shëndetësore për ato që shpesh janë pjesët më të varfra ose më të cenueshme të popullsisë. Monitorimi i dobët i cilësisë së ujit në zonat ku është e përhapur qasja e ulët në shërbimet publike dhe rrjetet e ujësjellësit kërcënon ta përkeqësojë më tej këtë problem. Evidencat globale dhe rajonale tregojnë njohje në rritje të faktit se vetë-furnizimi do të mbetet pjesë e miksit të ofrimit të shërbimeve për realizimin e shërbimeve universale të menaxhuara në mënyrë të sigurt, dhe këtu do të duhet të faktorizohet edhe mbështetja e rregullt. Sa i përket menaxhimit të shërbimeve sanitare dhe të ujërave të zeza, nivelet përgjithësisht të ulëta të qasjes në shërbime të përmirësuara sanitare dhe të grumbullimit të ujërave të zeza të bazuara në sisteme të kanalizimeve në disa vende, veçanërisht në zonat rurale, nënkuptojnë që ka nevojë për një zhvendosje themelore të qasjes për të arritur cilësinë e jetës dhe objektivat mjedisore. Edhe këtu, banorët po vetë-furnizohen duke ndërtuar gropa septike/puseta kulluese, ndërsa shërbimet e zbrazjes (ose vetë-zbrazja), dhe gjithashtu instalimi i saktë i zgjidhjeve teknike adekuata është kryesisht i parregulluar. Modelet e ofrimit gjithashtu do të duhet të pasqyrojnë zgjidhjet e ndryshme të shërbimeve sanitare, përtej kanalizimeve (sisteme të decentralizuara, sisteme në lokacion me zbrazje të rregulluar, etj.), të cilat njihen gjithashtu në kuadër të UWWTD (shërbime sanitare të përshtatshme individuale). Për trajtimin e ujërave të zeza, eksplorimi i potencialit për ripërdorimin e ujërave të zeza dhe për kalimin në paradigmen e re “nga mbeturinat në resurs”, ka potencialin për të shndërruar një problem të rëndë në një mundësi për modelin e ekonomisë qarkore. Për të përmbledhur sa u tha më sipër, për të përparuar në agjendën e aderimit, vendet do të duhet: i) të adoptojnë një “qasje portofoli” për shërbimet e ujësjellësit, duke mbështetur zgjidhje të shumta për qasje universale, dhe duke mbështetur skemat e vetë-furnizimit; ii) të përshkallëzojnë investimet në zonat rurale për shërbimet sanitare, përfshirë vetë-investimet në nivel të ekonomive familjare dhe zgjidhjet individuale; dhe iii) të adoptojnë qasje të reja teknike, institucionale dhe të financimit për menaxhimin e ujërave të zeza.
- ▶ **Së dyti, shërbimet komunale të ujësjellësit dhe ato sanitare nuk janë gjithmonë të menaxhuara mirë, as nuk performojnë në mënyrë të kënaqshme as nuk operojnë në bazë të qëndrueshme financiare** - që është parakusht nëse synohet përmbushja e sfidave të mësipërme dhe ofrimi i shërbimeve me cilësi të mirë për qytetarët. Vendet duhet të përqendrojnë përpjekjet e tyre në përmirësimet e nevojshme në këto fusha në mënyrë që progresi i shënuar të mos ketë ngecje - ose, më keq, të përmbysset. Performanca dhe efikasiteti i përmirësuar i shërbimeve komunale do t’ia mundësojë ofruesve të shërbimeve që të përmirësojnë më tej qëndrueshmërinë financiare dhe të sjellin financimin shtesë që kërkohet për të zgjeruar mbulimin dhe të vazhdojnë të mbajnë dhe të përmirësojnë ofrimin e shërbimeve. Së këndejmi, në këto vende është e nevojshme një qasje afatgjatë për të krijuar një cikël të virtutshëm për t’u përqendruar në përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare dhe përshtatshmërisë kreditore të shërbimeve komunale, nëpërmjet promovimit të përmirësimeve të efikasitetit të cilat gradualisht do të ulin nevojat për financimin e përgjithshëm. Qëndrueshmëria më e fortë financiare do të përmirësojë gjithashtu shanset për tërheqjen e financimit tregtar shumë të nevojshëm për sektorin. Realizimi i kësaj do të ndihmojë jo vetëm që të ofrohet qasja dhe qëndrueshmëria lidhur me agjendën e OZHQ-ve, por edhe të zvogëlohet barra për buxhetet e kufizuara fiskale.

**E gjithë kjo po ndodh kundrejt sfondit të një konteksti të ndryshueshëm shoqëror dhe ndryshimit të tendencave të popullsisë. Popullsia totale në rajon po zvogëlohet, dhe njerëzit po migrojnë si nga rajoni ashtu edhe brenda tij në kërkim të mundësive të ndryshme.** Në të njëjtën kohë, migracioni drejt BE-së në përgjithësi po rritet (vetëm në 2015 dhe 2016, më shumë se 1 milion njerëz hynë në rajonin evropian, kryesisht duke ikur nga zonat e afërta të konfliktit). Politikat e përfshirjes humanitare dhe me shënjestrim social për ofrimin e shërbimeve do të duhet të zhvillohen më tej, jo vetëm për t’u marrë me aspektet e migracionit, por për të adresuar pabarazitë e mëdha në nivelet e varfërisë - përgjatë grupeve socio-ekonomike dhe etnike dhe nëpër qendrat e popullsisë urbane dhe zonat rurale ose më të shpërndara. Këto kontraste ekzistojnë në shumicën e vendeve të rajonit dhe në të vërtetë reflektohen në nivelin e qasjes në shërbime nga ana e këtyre grupeve. Sezonaliteti gjithashtu duhet të faktorizohet për zhvillimin e ardhshëm të sektorit të shërbimeve të ujësjellësit dhe sanitare. Kjo për shkak se flukset në rritje të turizmit do të ndikojnë në planifikimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe atyre sanitare në të ardhmen, dhe dimensionimi i duhur i sistemeve dhe infrastrukturës është tashmë problematik në shumë qytete turistike në rritje në të gjithë Evropën Jugore dhe Lindore.

**Modelet klimatike gjithashtu po ndryshojnë, dhe temperaturat gjithnjë e më të ngrohta janë bërë realitet.** Ndërtimi i rimëkëmbshmërisë (si në infrastrukturë ashtu edhe në institucione) ndaj rreziqeve klimatike dhe të lidhura me ujërat do të bëhet thelbësor në mënyrë që vendet të vazhdojnë të ofrojnë në mënyrë efektive dhe efikase shërbime të ujit dhe të ujërave të zeza. Të dhënat dhe njohuritë e përmirësuara, talenti njerëzor dhe teknologjitë e reja duhet të shfrytëzohen, që të gjitha, për ta bërë këtë gjë. Politikat e ujërave do të kërkohet që të marrin parasysh aspektet klimatike, dhe shërbimet e ujësjellësit dhe ato sanitare në rajon - dhe personeli dhe menaxhimi i tyre - do të duhet t'i operojnë këto shërbime dhe ta planifikojnë zhvillimin e infrastrukturës në kushte të pasigurisë më të lartë. Ata do të duhet të mësojnë të bëjnë planifikimin e "sigurisë së ujit" në përputhje me mekanizmat e tyre të zhvillimit hapësinor dhe të planifikimit të baseneve dhe të prezantojnë përdorimin e modeleve të skenarëve të klimës dhe disponueshmërisë së ujit për të caktuar prioritetet dhe për të ekzekutuar investimet duke marrë parasysh kontekstin e nivelit të basenit, sipas qasjes së sigurisë së ujit.

**Më në fund, drejtimi i sektorit të ujësjellësit dhe shërbimeve sanitare në shekullin e 21-të duke synuar shërbime të përmirësuara në kontekstin rajonal do të kërkojë që qeveritë në rajon të përdorin politika të bazuara në evidencë, të investojnë në njerëz dhe të nxisin zhvillimin e partneriteteve.** Digjitalizimi i industrisë së ujërave dhe teknologjitë e reja ka të ngjarë të vazhdojnë të ofrojnë plot mjete për të përmirësuar praktikën dhe operacionet, të cilat shërbimet komunale "inteligjente" (dhe të forta) do të jenë në gjendje t'i përdorin në varësi nga nevojat dhe prioritetet e tyre specifike të biznesit. Por, suksesi nuk do të jetë i mundur pa investuar në faktorin **njeri**. Në rajon do të ketë kërkesë të madhe për profesionistë të kualifikuar dhe të motivuar. Ky grup profesionistësh do të jetë i gamës së gjerë, duke shkuar nga politikbërësit dhe vendimmarrësit deri te shkencëtarët, te profesionistët me njohuri të thella të çështjeve të ujërave, te menaxherët e shërbimeve komunale për ujësjellës dhe shërbime sanitare, deri te personeli teknik dhe operativ. Në të njëjtën kohë, këta profesionistë do të duhet të jenë të aftë për koordinim më të gjerë dhe më të thelluar midis niveleve qendrore dhe lokale të autoriteteve të sektorit, dhe në radhët e agjentëve kryesorë të përfshirë në planifikimin e basenit - përfshirë autoritetet e basenit, ofruesit e shërbimeve, fermerët, industrinë, etj. dhe qytetarët. Vendet do të mund të përdorin mundësitë e ofruara nga nismat dhe platformat e ndryshme rajonale për të forcuar më tej politikën e tyre dhe për të ndërtuar kapacitetet e shërbimeve komunale të ujësjellësit dhe shërbimeve sanitare dhe ofruesve të shërbimeve. Angazhimi më i madh i qytetarëve dhe **partneritetet më të forta lokale, rajonale dhe ndërkombëtare**, publike dhe private, mund të ushqehen dhe të lulëzojnë në këto kapacitete të forcuara për të zgjeruar mundësitë për përparim dhe ofrojnë shteg jo vetëm për ujësjellës dhe shërbime sanitare më të qëndrueshme, por edhe për rritje të sigurisë së ujit për të gjithë në rajon.

## SHTOJCA A: PASQYRAT E VENDEVE

Pasqyrat e vendeve që pasojnë listojnë treguesit kryesorë që përdoren përgjatë raportit dhe vlerat e mbledhura gjatë përpjekjes për mbledhjen e të dhënave lidhur me Situatën e Sektorit (SoS), për secilin vend, së bashku me vitin dhe burimin e tyre dhe japin krahasimin me mesataren e rajonit (të ponderuar sipas popullsisë).



# SHQIPËRIA

Vend Kandidat për BE

Vlerësimi i qëndrueshmërisë së sektorit

**55** ↑  
2018

**49**  
2015



Treguesi	Viti	Burimi	Vlera	Mesatarja e kand. për BE	Mesatarja e Danubit	Më e mira e Danubit
<b>Konteksti për shërbimet</b>						
<b>Situata socio-ekonomike</b>						
Popullsia [M. banorë]	2013	(World Bank, 2015)	2,774	3,053	8,451	n.a.
	2017	(World Bank, 2017)	2,873	2,990	8,362	n.a.
Evucioni demografik [1990 – 2017] [%]	1990-2017	Elab. i autorëve	43	9	-6	n.a.
Pjesa e popullsisë urbane [%]	2013	(World Bank, 2015)	55	51	63	n.a.
	2017	(World Bank, 2017)	59	52	64	n.a.
PBB për frymë, PPP [\$ ndërkombëtare aktuale]	2013	(World Bank, 2015)	10,489	11,154	16,902	n.a.
	2017	(World Bank, 2017)	11,803	12,772	18,830	n.a.
Popullsia nën kufirin e varfërisë [\$2.50 në ditë [PPP] [% e pop]]	2012	(World Bank, 2015)	6.7	3.55	1.65	n.a.
<b>Organizimi administrativ</b>						
Nr. i njësive të qeverisjes lokale [komuna]	2014	(MSCV, 2014)	374	85	1,987	n.a.
	2017	(MI, 2017)	61	85	1,895	n.a.
Madhësia mes. e njësive të qeverisjes lokale [banorë]	2013	Elab. i autorëve	7,416	35,850	4,253	n.a.
	2017	Elab. i autorëve	47,106	35,106	4,412	n.a.
<b>Resurset ujore</b>						
Disponueshmëria totale e resurseve të ripërtëritshme të ujit [m <sup>3</sup> /cap/vit]	2008-2012	(FAO Aquastat, 2015)	9,551	8,128	7,070	n.a.
	2014	(FAO AquaStat, 2014)	10,425	10,408	9,488	n.a.
Nxjerrjet vjetore të ujërave të ëmbla, të brendshme [% e nxjerrjes totale]	2013	(World Bank, 2015)	43	18	26	n.a.
	2018	(World Bank, 2018)	43	41	32	n.a.
Pjesa e ujërave sipërfaqësore si burim i ujit të pijshëm [%]	2014	(ICPDR, 2015)	17	42	31	n.a.
	2017	Agjencia e Resurseve Ujore	17	29	28	n.a.
<b>Organizimi i shërbimeve</b>						
Numri i ofruesve formalë të shërbimeve të ujit	2013	(GDWSS, 2013)	58	75	661	n.a.
	2017	ERRU	58	78	748	n.a.
Popullsia e shërbyer - mesatarja [banorë]	2013	Elab. i autorëve	36,822	28,963	9,496	n.a.
	2017	Elab. i autorëve	38,792	30,171	8,490	n.a.
Lloji mbizotërues i ofruesit të shërbimeve	Kompanitë aksionare të ujit dhe kanalizimeve					
Fushëveprimi i shërbimeve	Uji dhe/ose shërbimet sanitare					
Pronësia	Qeveritë lokale					
Shtirirja gjeografike	Kryesisht disa qeveri lokale					
Ligj për shërbimet e ujit?	Jo					
Ministri e vetme e linjës?	Po [Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë]					

Treguesi	Viti	Burimi	Vlera	Mesatarja e kand. për BE	Mesatarja e Danubit	Më e mira e Danubit
Agjenci rregullatore?			Po [ERRU]			
Treguesit e performancës së ndërmarrjeve të shërbimeve komunale janë në dispozicion të publikut?			Po [www.erru.al]			
Shoqatë Kombëtare e Ndërmarrjeve të Shërbimeve Komunale?			Po [SHUKALB për ujësjellës dhe ujëra të zeza]			
Pjesëmarrja e sektorit privat			Vetëm nëpërmjet eksternalizimit të shërbimeve			

